



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:065190
Datë: 11.06.2024
Numri i dokumentit: 05806037

SCC – 09 - 0140

Paditësi:

P L nga fshati P Prishtinës, tani Komuna e Graçanicës e të cilin me autorizim e përfaqëson, av.
Z M nga Prishtina.

Kundër:

Të paditurës:

Kombinati Bujqësor Industrial (KBI), "Kosova – Export", Organizata Bazë e Punës së Bashkuar (OBPB) "Prodhimtaria Bujqësore me blegtori" me seli në fshatin D të Komunës së Fushë Kosovës e cila përfaqësohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit me seli në Prishtinë, Lagjja, "Lakrishtë", Rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Prishtinë.

Objekti i çështjes: Kthimi në posedim dhe pronësi i patundëshmërisë.

Për : Palët ndërgjyqëse.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), me Kolegjin në përbërje nga gjykatësit, Agron J. Hoxhaj, gjykatës kryesues, gjykatësen, Manushe Karaçi dhe gjykatësin, Hasim Sogojeva, anëtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur, **me dt.11.06.2024**, merr këtë:

A K T V E N D I M

I. HEDHET poshtë si e pa pranueshme padia e paditësit, P L nga fshati P i Komunës së Graçanicës.

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale në këtë çështje juridike kontestimore.

Rrethanat Procedurale dhe Faktike :

Me dt.21.07.2009, paditësi përmes të të autorizuarit të tij, av. Z M nga Prishtina, pranë DhPGjSK-së, ka paraqitur padinë kundër të paditurës, Kombinati Bujqësor Industrial (KBI), "Kosova – Export", Organizata Bazë e Punës së Bashkuar (OBPB) "Prodhimtaria Bujqësore me blegtori" me seli në fshatin D të Komunës së Fushë Kosovës e cila është nën menaxhimin dhe përfaqësohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit me seli në Prishtinë dhe atë për shkak të kthimit në posedim dhe pronësi të patundshmërisë dhe atë të ngastrës kad.nr..., me kulturë, "tokë bujqësore" në vendin e quajtur, "...", në sipërfaqe prej 01,41.33 ha, nga fleta poseduese, nr..., Zona Kadastrale (ZK), P, Komuna e Prishtinës.

Paditësi, në këtë padi, ka theksuar se e paditura, pa vullnetin e paditësit, e ka bërë shpronësimin e patundshmërisë në ngastrën kadastrale, nr.. me kulturë, "tokë bujqësore" në vendin e quajtur, "...", në sipërfaqe prej 01,41.33 ha, nga fleta poseduese, nr..., Zona Kadastrale (ZK), P, Komuna e Prishtinës, dhe atë me presion dhe kërcënimin se patundshmërinë e lartëcekur, duhet shitur të paditurës me çmimin të cilin ajo e diktonte (kuptohet se kemi të bëjmë me sistemin monist – komunist) më konkretisht kemi të bëjmë me shprehjen e vullnetit vetëm të njëjës palë në rastin konkret vetëm të paditurës dhe arë për çmimin e tërësishëm për ngastrën lëndore, nr.505/2 në shumë prej 84,798.00 dinarë dhe se si provë ka referuar në kontratën e shitblerjes, se ka ekzistuar presioni i vazhdueshëm për shitblerje dhe se çmimi ka qenë mbi nën mesataren e tregut të saja kohe mund të dëshmojnë edhe dëshmitarët të asaj kohe, M K dhe D L që të dytë nga fshati P i Komunës së Prishtinës e duke referuar si provë në deklaratat e dëshmitarëve.

Tutje, ka shtuar se pasi që pala paditëse, në këtë çështje juridike nuk ka mundur që të ketë ndikim në transaksionin juridiko – civil i cili është bërë pa vullnetin e palës paditëse, nën çmimin e tregut, prandaj ai është i gatshëm që t'i kthej paratë e pranuarat të konvertuara në euro sipas ekspertit për ekonomi dhe financat në afatin të cilin do t'ia caktoj gjykata, se patundshmëria e cekur e paditësit, ka qenë pronë e tij, dëshmohet edhe me fletë posedimin e dt..., Zona Kadastrale, P, ngastra kadastrale, nr..., në sipërfaqe prej 01,41.33 ha, që tani është kontestuese, e cila pronë tani evidentohet në emër të të paditurës, dhe ka referuar në provën, leximin e fletë posedimin të dt..., Zona Kadastrale, P, se juridiksioni parësor i Dhomës, bazohet në nenin 4.1 pika (c) të Rregullorës, Nr.2002/13 në cilësinë e të paditurës, paraqitet ndërmarrja shoqërore e cila aktualisht është nën autoritetin e administrativ të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, se AKM –ja – AKP –ja, është njoftuar lidhur me inicimin e procedurës gjyqësore konform nenit 29 të Rregullores, Nr.2002/12 dhe ka referuar në provën, Njoftimin në fjalë.

Po ashtu ka theksuar edhe se baza e padisë së tij mbështetet në nenin 8 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësores – Juridike, e me arsyet e cekura, paditësi, ka ushtruar këtë padi dhe i ka propozuar gjykatës që të caktoj shqyrtimin kryesor, t'i administroj provat e cekura më lartë dhe pas vlerësimit të të njëjtave, të merr aktgjykim e me të cilin aprovet kërkesëpadia dhe vërtetohet se paditësit, P L është pronar i patundshmërisë së ngastrës kadastrale nr..., me kulturë, "tokë bujqësore" në vendin e quajtur, "...", në sipërfaqe prej 01,41.33 ha, nga fleta poseduese, nr..., Zona Kadastrale (ZK), P, Komuna e Prishtinës dhe obligohet pala paditëse, që t'ia kthej të paditurës, paratë e pranuarat dhe të konvertuara në euro sipas ekspertizës në afat prej 30 ditësh si dhe të detyrohet, Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi në Prishtinë që të bëjë ndryshimet në operatin kadastral sipas këtij aktgjykimi, si dhe se secila palë t'i bartë shpenzimet.

Paditësi, kësaj padia, ia ka bashkangjitur provat :

- Deklaratën e vërtetuar në gjykatë të dt.23.05.2008 të D L nga fshati P i Komunës së Prishtinës;
- Kopjen e autorizimit të dt.21.05.2008 të dhënë nga paditësit për av. Z B nga Prishtina;
- Kopjen e fletës poseduese, nr..., Zona Kadastrale (ZK), P, Komuna e Prishtinës të lëshuar me dt.21.04.1972 nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi në Prishtinë ;
- Kopjen e Njoftimit të dt.14.07.2008 të paditësit të dërguar në adresë të të paditurës për iniciimin e procedurës gjyqësore pranë Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme ;

Me dt.15.02.2011, DhPGjSK-ja, me Urdhrin e saj, SCC- 09- 0140 të dt.15 shkurt 2011, ka urdhëruar paditësin që të bëjë përkthimin në gjuhën angleze të autorizimit, shkresat tjera të lëndës si dhe t'a specifikoj adresën e tij dhe se pas pranimit të këtij Urdhri, me dt.18.02.2011, i autorizuari i paditësit, nuk ka vepruar sipas këtij Urdhri.

Me dt.14.05.2024, DhPGjSK-ja, me Urdhrin e saj, SCC- 09- 0140 të dt.14.05.2024, ka urdhëruar paditësin, dhe av. Z M nga Prishtina, që në afatin prej 15ditëve pas ditës së pranimit të këtij Urdhri, të bëjë precizimin e kërkesëpadisë së tij si dhe t'a bëjë plotësimin e padisë së tij në atë mënyrë që kësaj padie, t'ia bashkangjesin autorizimin më të ri të dhënë nga vet paditësi për av. Z B nga Prishtina për t'a përfaqësuar pranë DhPGjSK-së dhe padisë së tij, t'ia bashkangjes provën e cekur në këtë padi, pra kontratën e shitblerjes si dhe të deklarohet se cila prova dëshiron t'i propozoj për administrim në këtë çështje juridike kontestimore e nën kërcënimin e pasova gjegjëse ligjore në rast të mos veprimit sipas këtij urdhri pra nëse paditësi, si dhe të autorizuari i tij nuk vepron brenda afatit të dhënë dhe me detyrimin e dhënë për të njëjtë, sipas pikës I të dispozitivit të këtij urdhri, gjykata në bazë të nenit 36 par.3 dhe nenit 76par.3 të Ligjit, Nr.06/L – 086 të dt.30 maj 2019 të Dhomës e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), padinë e tyre, do t'a hedh poshtë mbi bazat e papranueshmërisë ose të njëjtën padi, nenin 99 dhe nenin 102 par.1 të LPK-së, do t'ia hedh poshtë si jo të plotë dhe se pala paditëse, si dhe ia autorizuari i saj, pas pranimit të këtij urdhri me dt.24.05.2024 përkatësisht me dt.29.05.2024, pas kalimit të afatit të dhënë në këtë urdhër por edhe deri më tani nuk kanë vepruar sipas Urdhrit të kësaj gjykate, SCC- 09- 0140 të dt.14.05.2024.

Arsyetimi ligjor:

Padia e paditësit, P L nga fshati P i Komunës së Graçanicës, hudhet poshtë si e papranueshme.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par. 1 pika 1 të Ligjit, Nr.06/L - 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK) për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, lidhur me nenin 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjykata vlerëson se faktet dhe provat që i përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe gjykata marr aktvendim, pa caktuar seancës dëgjimore.

Në bazë të nenit 33 dhe nenin 35 të Ligjit Nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, bëhet fjalë për rregullimin e parashtrësive përkatësisht të kërkesave dhe

nisjen e procedurave në Dhomën e Posaçme dhe se në nenin 35 par.2 të këtij ligji parashihet se çka duhet të përmbaj një kërkesë/padi, si në rastin konkret.

Po ashtu në nenin 36 paragrafi 2, pika 2.5 dhe paragrafi 3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme parashihet se: *"Një kërkesë/ankesë është e pranueshme nëse: ... Dhoma e Posaçme ka juridiksion në bazë të nenit 5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme; ... Nëse Gjyqtari i vetëm apo Kolegji, vlerëson se kushtet e përcaktuara me paragrafin 2 të këtij neni nuk janë përmbushur, atëherë ai hedh poshtë kërkesën/ankesën në baza të papranueshmërisë si dhe saktëson në hollësi bazën ligjore për refuzimin e tillë"*.

Ndërsa në nenin 42 par.2 dhe 3 i Ligjit për Dhomën e Posaçme, parashihet se: *"Pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësuar apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese) ..."* kurse sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), palët kanë për detyrë t'i paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla e me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet t'a dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Derisa në nenin 99 lidhur me nenin 102 të LPK-së, që kanë të bëjnë me hudhjen poshtë si jo të plotë të një padie në procedurën kontestimore sepse e njëjta padi, ka mangësi sa i përket të dhënave, duhet t'i kishte për të vepruar sipas saj, e dispozita këto të cilat në rastin konkret, duhet të zbatohen përshtatshmërisht sipas 76 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme e në nenin 99 par.2 të LPK-së, parashihet se: *"Parashtrësuar duhet të jenë të kuptueshme dhe të përmbajnë çdo gjë që nevojitet dhe e mundëson veprimin sipas tyre"* derisa në nenin 102 par 3 të LPK-së, parashihet se: *"... Do të konsiderohet se është tërhequr parashtrësuar po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësuar do të hidhet poshtë"*. Në rastin konkret, kjo gjykatë, me Urdhrin e saj, SCC- 09 - 0140 të dt.14.05.2024, ia ka dhënë mundësinë paditësit, për të plotësuar kushtin e pranueshmërisë së padisë/kërkesës së tij në atë mënyrë që në afatin prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të këtij Urdhri, që të bëjë precizimin e kërkesëpadisë së tij e më gjerësisht si në këtë Urdhër e nën kërcënimin e pasojave gjegjëse ligjore në rast të mos veprimit sipas pikës I të këtij Urdhri, në mes tjerash, padia e tij, do të hedhet poshtë si e pa pranueshme ose do të refuzohet si e pabazuar.

Ndërsa përkitazi me çështjen e autorizimit, me nenin 32 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK), me të cilin është përcaktuar se secili paditës apo i paditur përfaqësohet nga një anëtarë i Odës së Avokatëve, rezulton se avokati të cilit i adresohet ky urdhër, pra av.Z B nga Prishtina, duhet të ketë autorizimin e dhënë personalisht nga paditësi, P L nga fshati P i Komunës së Graçanicës e përveç kësaj, edhe me nenin 33 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, është përcaktuar se *"Origjinali i çdo parashtrësuar duhet të nënshkruhet nga pala ose avokati i palës, nëse pala ka përfaqësues të autorizuar"*. Në rastin konkret në dosje të lëndës, në të vërtetë ekziston kopja e autorizimit të dt.21.05.2008 e dhënë pala paditëse për av. Z B nga Prishtinë por jo edhe origjinali i tij dhe se për këtë arsye edhe kjo gjykatë me Urdhrin e saj, SCC- 09 - 0140 të dt.14.05.2024, nga paditësi si dhe i autorizuari i tij, ka kërkuar që të sjellin autorizimin më të ri të dhënë nga pala paditëse për av. Z B nga Prishtina si dhe padisë së tij, t'ia bashkangjes kontratën gjegjëse të shitblerjes e më gjerësisht si në këtë Urdhër.

Mirëpo gjykata konstaton se sipas fletë kthesave të kësaj gjykate, paditësi si dhe i autorizuari i tij, secili veç e veç urdhrin e lartë cekur të kësaj gjykate, e kanë pranuar me dt.24.05.2024

gjegjësisht me dt.29.05.2024, por se të njëjtët as brenda afatit të caktuar në këtë urdhër por edhe deri më tani nuk ka vepruar sipas tij, për të bërë precizimin e padisë si dhe padisë së tij, paditësi, t'ia bashkangjes autorizimin më të ri të dhënë nga paditësi si dhe provat e kërkuara nga ai por edhe se paditësi, nuk kanë bërë kërkesë për zgjatjen - vazhdimin e afatit për të vepruar sipas Urdhrit të lartë cekur, dhe se sipas vlerësimit të kësaj gjykate, paditësi, ka dështuar në përmbushjen e kërkesës së dhënë në Urdhrin e kësaj gjykate, SCC- 09- 0140 të dt.14.05.2024, andaj edhe për këtë arsye, Kolegji i kësaj gjykate, gjeti se padia e paditësit, P L nga fshati P i Komunës së Graçanicës, duhet të hedhet poshtë si e pa pranueshme.

Shpenzimet Gjyqësore

Në bazë të nenin 62 par.5 të Ligjit nr. 06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK), gjykata vendosi që secila palë t'i bart shpenzimet e veta procedurale në këtë çështje juridike kontestimore.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 4 par.9, nenit 9, 33, 35, 36 dhe nenit 76 par.3 të Ligjit nr. 06/L - 086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK) lidhur me nenin 99 dhe nenin 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK).

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS 2023:065190, 11.06.2024

Kolegji i shkallës së I-rë i DhPGjSK-së

Agron Hoxhaj, Gjykatës kryesues _____

Hasim Sogojeva, Gjykatës _____

Manushe Karaçi, Gjykatëse, _____

KËSHILLË JURIDIKE :

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme dhe atë brenda **15 (pesë mbëdhjetë) ditëve** pas ditës së pranimin të këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK).